

FJALA SI NJËSI E LEKSIKUT SIPAS GJUHËTARIT HAJRI SHEHU

Orjeta BAJA¹

1 Department of Linguistic, Faculty of Social Sciences, University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"*

Corresponding author e-mail: orjeta.baja@unishk.edu.al

Përmbledhje

Ndriçimi i konceptit për *fjalën* ka zënë një vend të konsiderueshëm në mjaft diskutime e studime nga shumë gjuhëtarë shqiptarë, kryesisht leksikologë e leksikografë. Një nga këta studiues, që i ka kushtuar gjithë veprimtarinë e tij shkencore *fjalës shqipe*, duke hulumtuar për vlerat, funksionet, veçoritë që e dallojnë këtë njësi, si dhe për përzgjedhjen e pasqyrimin në fjalorët shpjegues njëgjuhësh, në fjalorët dygjuhësh apo në fjalorët krahinorë, e sidomos për rolin e saj brenda sistemit leksikor e leksikografik, është profesor Hajri Shehu, një nga leksikografët tanë profesionistë më të spikatur.

Objekt i këtij artikulli janë punime shkencore të gjuhëtarit H. Shehu mbi sistemin leksikor të shqipes kryesisht në revistën "*Gjuha shqipe*" (organ i Institutit Albanologjik të Prishtinës), si dhe përmbledhja e tij studimore me titull "*Studime për leksikon dhe për leksikografinë e sotme shqipe*" I (2015), me një tematikë të gjerë, referuar leksikologjisë e leksikografisë (sidomos leksikut popullor me vlerë potenciale për gjuhën e sotme shqipe), fjalëformimit në gjuhën shqipe e kulturës së gjuhës, që dëshmojnë qartë kompetencën e lartë shkencore të autorit. *Ç'është fjala në konceptin leksikografik* është çështja kryesore e punimit tonë, referuar këndvështrimit të leksikografit Shehu përmes veprimtarisë së tij gjuhësore – veprimtari që e vlerësojmë si një pasuri të çmuar kombëtare.

Fjalë kyçe: fjalë, leksik, fjalor, leksikografí, shqip, koncept.

Hyrje

Janë bërë shumë studime në gjuhësi për konceptin "fjalë", por mbeten ende mjaft çështje të diskutueshme. Edhe në gjuhësinë shqiptare, ndriçimi i konceptit për *fjalën* ka zënë një vend të konsiderueshëm në mjaft diskutime e studime nga shumë gjuhëtarë, kryesisht leksikologë e leksikografë. Një nga këta studiues, që i ka kushtuar gjithë veprimtarinë e tij shkencore *fjalës shqipe*, duke hulumtuar për vlerat, funksionet, veçoritë që e dallojnë këtë njësi, si dhe për përzgjedhjen e pasqyrimin në fjalorët shpjegues njëgjuhësh, në fjalorët dygjuhësh apo në fjalorët krahinorë, e sidomos për rolin e saj brenda sistemit leksikor e leksikografik, është profesor Hajri Shehu, një nga leksikografët tanë profesionistë më të spikatur.

Emri i H. Shehut identifikohet me një numër të madh botimesh për *fjalën* dhe *sistemin leksikor* të shqipes. Së pari, identifikohet me veprat leksikografike normative kombëtare, ku tek secila prej tyre është bashkëhartues: "*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*" (1980), "*Fjalor i shqipes së sotme*" (1984) dhe botimin e tij të shpolitizuar e të plotësuar (2002), "*Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*" (2004), "*Fjalor i gjuhës shqipe*" (2006), "*Fjalor elektronik i gjuhës shqipe*" (2014), "*Fjalor i vogël i gjuhës shqipe*" (2020).

Gjithashtu, gjuhëtari Hajri Shehu është autor e bashkautor edhe i disa fjalorëve të tjerë shqip e anglisht-shqip, si dhe autor i disa monografive e i shumë artikujve shkencorë të botuar në disa revista shkencore, si: “*Studime filologjike*”, “*Gjuha jonë*”, “*Gjuha shqipe*”, “*Studia Albanica*”, “*Lexicography*” (Oxford) etj., kryesisht në fushat e leksikologjisë, të leksikografisë, të fjalëformimit e të sintagmatikës të gjuhës shqipe.

I. Pas një vëzhgimi të hollësishëm të revistës “**Gjuha shqipe**” (organ i Institutit Albanologjik të Prishtinës), në të cilën janë të shumta shkrimet e prof. Hajri Shehut, dallon qartë që kontributi gjuhësor i tij lidhet kryesisht me sistemin *leksikor të shqipes*. Ata shfaqen me një tematikë gati homogjene në pikëpamje të fushës së studimit, përmes artikujsh të tillë, si: “*Fjalori i gjuhës shqipe*” (2006) dhe kultura kombëtare, 3 / 2007; *Gjuha jonë, sa e mbajnë të pastër mediat*, 2 / 2009; *A duhet botuar një fjalor shpjegues shkollor i gjuhës shqipe?*, 1 / 2013; *Për një fjalor të përgjithshëm dialektor të gjuhës shqipe*, 2 / 2013; *Për një fjalor drejtligjërimit të gjuhës shqipe*, 3 / 2013; *Për gjuhën e reklamave televizive dhe radiofonike*, 1 / 2021; *Për përkthimin e teksteve teknike*, 2 / 2021; *Aleksandër Xhuvani, “Fjalor i gjuhës shqipe”*, 3 / 2021; *Për fjalën ‘njëmendësohem’ dhe disa formime të tjera në librin “Pacienti ynë i veçantë”, i prof. dr. Ahmet Kamberit*, 2 / 2023 etj.

Në artikullin me temë “**Fjalori i gjuhës shqipe**” (2006) dhe kultura kombëtare¹, leksikologu H. Shehu sjell në vëmendje traditën e vyer (sot 389-vjeçare – shën. im O. B.) që kemi në hartimin e fjalorëve të shqipes. Në lidhje me “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006), si njëri nga autorët e tij, ai shprehet se “Fjalori ruan në shkallën më të lartë vlerat kryesore të fjalorëve të mëparshëm shpjegues të shqipes dhe ka synuar “t’i rritë këto vlera” me fjalë, kuptime etj. Në këtë Fjalor (me rreth 48000 fjalë) janë përfshirë shumë fjalë, shprehje e kuptime që përdoren sot në shqipe e që nuk kanë qenë në fjalorët e mëparshëm të shqipes. Këto fjalë të reja janë nxjerrë nga letërsia e sotme artistike, shkencore, politike, fetare, nga fjalorët dygjuhësh, nga tekstet shkollore, nga gazetatat, nga fjalorët krahinorë etj.”²

Prof. Shehu vë në dukje se ky Fjalor vjen i pasuruar, duke kujtuar edhe faktin që në një fjalor, e reja është detyrë e përhershme dhe punë e përhershme. Ai nënvizon se “në këtë Fjalor kanë ardhur fjalë e formime fjalësh që sjellin nocione e dukuri të reja të kohës, që janë terma të rinj, sidomos nga fusha e informatikës, e ekonomisë dhe e financës, e politikës, e pluralizmit etj.”³. Autori shkruan: “Gjuha nuk mund të mos varet nga kushtet në të cilat jeton shoqëria, nga niveli i zhvillimit të saj, në fund të fundit, nga njerëzit që e flasin gjuhën, nga veprimtaria e tyre, e cila mund të formësohet edhe si program i politikës gjuhësore (kuptojmë programin e Rilindjes Kombëtare). Nuk mund të rivinin, le të themi: *bashki, komunë, prefekturë, qark* etj. pa ndryshimet politike të viteve ‘90 të shekullit të kaluar”⁴.

Për fjalorët dygjuhësh e terminologjikë (të degëve të shkencave e të teknikave) mund të krahasohemi me vende të zhvilluara evropiane, - thekson autori, dhe bën një përqasje me Fjalorin e parë në Britani: “Në shqipe, fjalori i parë latinisht – shqip është botuar nga Frang Bardhi më 1635; në Britani, fjalori i parë latinisht – anglisht është botuar më 1588.”⁵. Gjuhëtari ynë i kushton vëmendje të posaçme edhe *ndikimit të fjalorëve në kulturën gjuhësore* për të cilët shprehet: “Fjalorët janë ndërmjetësuesit midis gjuhës e folësve të saj. Në një kuptim më të ngushtë, gjuha është institucion kulturor, domethënë, ajo ruan trashëgiminë kulturore të ligjërimit të bashkësisë... Fjalorët i shkojnë pas gjuhës, e ndjekin atë. Fjalorët nuk janë ligjëbërës. Do të ishte doktrinë e gabuar nëse fjalorët do të veçoheshin nga marrja e dhënia me komunikimin njerëzor”⁶.

¹ H. Shehu, *Fjalori i gjuhës shqipe*” (2006) dhe kultura kombëtare, në “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 3 / 2007, fq. 13.

² *Po ai, po aty*, fq. 14.

³ *Po ai, po aty*, fq. 14.

⁴ *Po ai, po aty*, fq. 15.

⁵ *Po ai, po aty*, fq. 13.

⁶ *Po ai, po aty*, fq. 15.

Një çështje me rëndësi e shtruar nga autori në këtë artikull është: *A duhet të përfshijë fjalë e shprehje popullore dialektore e krahinore një fjalor shpjegues i gjuhës shqipe standarde?* Dhe ka mendimin që *dialektet e të folmet truallsore të shqipes kanë shërbyer e shërbejnë si burime të pazëvendësueshme të pasurimit të fjalorëve kombëtarë; gjuha standarde dhe fjalori i saj ushqehen nga dialektet dhe të folmet*⁷. Gjithashtu, i kushton vëmendje të posaçme rëndësisë së gjurmimit dhe zbulimit të vlerave të gjuhës së popullit nga studiuesit e intelektualët dashamirës të përparimit të gjuhës. *Edhe sot, - thotë ai, - gjurmimi e zbulimi i vlerave të gjuhës së popullit është një nga drejtimet e gjuhësisë shqiptare, por në të vërtetë, jo me atë fuqishmërinë e disa viteve më parë*⁸.

Në fund të kësaj çështjeje, profesori sjell një ndodhi të treguar, subjektin e së cilës e pamë me vlerë ta shkëpusim edhe për këtë trajtesë: “Një mbledhës folkori do të shkonte te një i moshuar. Ashtu i erdhi puna e nuk shkoi në ditën e caktuar. Po shkoj pasnesër, - tha ai. Por kur shkoi pasnesër, i thanë se plaku ... nuk jetonte më”. Brezat e brezatarët ikin e vijnë. Por duhet shpejtuar tek ata që ikin⁹ - udhëzon Shehu. Ajo që të tërheq vëmendjen nga shkrimet e studiuesit Shehu gjatë qëmtimit tonë në revistën në fjalë, është sistemorësia, si brenda artikullit, ashtu edhe brenda shtrirjes tematike të punimeve brenda revistës, duke ndjekur një linjë brenda një periudhe të caktuar, sidomos në shkrimet e tij të vitit 2013, në tre numra radhazi, nga fusha e leksikografisë:

Ndër to, përmendim së pari atë me titull *“A duhet botuar një fjalor shpjegues shkollor i gjuhës shqipe?”*¹⁰. Shkrimi hapet me paraqitjen e nevojës për një fjalor të tillë shpjegues. “Ka ardhur koha, - thotë ai, - të kemi jo vetëm një fjalor shpjegues shkollor të gjuhës shqipe, por disa fjalorë - sipas etapës së të mësuarit në shkollë, nivelit të dijeve të nxënësit, moshës së tij etj.”¹¹ E vijon mendimin duke pohuar se “ka ardhur koha të kemi edhe leksikografi shkollore (teori dhe praktikë që merret me hartimin e fjalorëve shkollorë), sepse fjalorët për shkollarë kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mësimin e gjuhës”.¹²

“Përveç se si mjet ndihmës e këshillues, - shton leksikografi Shehu më tej, - fjalori do të ishte një përdorak, në kuptimin e plotë të fjalës: Sa herë që nxënësi nuk e njeh një fjalë në leximet e tij a dëshiron të saktësojë diçka nga njohuritë e veta (një sinonim a antonim etj.), i drejtohet fjalorit. Në këtë mënyrë pasuron më tej gjuhën e tij, sepse rrit bagazhin e tij leksikor e frazeologjik.”¹³ Sugjerimin për hartimin e botimit të një fjalori shpjegues shkollor, prof. Shehu e lidh edhe me mësimin e gjuhës shqipe në diasporën shqiptare: “Teksti i gjuhës shqipe në diasporë kurrsesi nuk mund t’i plotësojë kërkesat për njohjen e leksikut e të frazeologjisë së shqipes. Shtu edhe atë që teksti është tekst dhe jo udhërrëfyes, siç është fjalori. Fjalori është edhe për prindër për t’u shpjeguar fëmijëve saktë fjalët.

Në një fjalor shkollor, zgjedhja e fjalësit është rreptësisht e paramenduar dhe sistemore. Përfshihen fjalët më të nevojshme për nxënësin dhe terminologjia më e re shkencore, madje, më e plotë se në një fjalor të përgjithshëm të gjuhës. Në një fjalor shkollor tregohet kujdes i posaçëm për gjuhën e shpjegimeve (metagjuhën). Ajo nuk mund të dalë tej caqeve të fjalëve që përfshihen në fjalor. Fjalë e shpjegimeve është e thjeshtë.”¹⁴ Janë këto disa nga arsytet e renditura nga gjuhëtari Shehu, të mbështetura mirë me argumente shkencore. Trajtimi vijon më tej, duke i kushtuar vëmendje të veçantë edhe parimeve e kritereve të hartimit të fjalorit të propozuar në atë vit (2013).

Studiuesi shkruan se *parimet dhe kriteret e hartimit të fjalorit shpjegues shkollor të gjuhës shqipe i përcaktojnë dhe i vendosin ata që do ta hartojnë*. Megjithatë, nuk lë pa bërë 3 sugjerime, që lidhen me:

⁷ *Po ai, po aty*, fq. 18.

⁸ *Po ai, po aty*, fq. 19.

⁹ *Po ai, po aty*, fq. 26.

¹⁰ H. Shehu, *A duhet botuar një fjalor shpjegues shkollor i gjuhës shqipe?*, në “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 1 / 2013, fq. 71.

¹¹ *Po ai, po aty*, fq. 71.

¹² *Po ai, po aty*, fq. 71.

¹³ *Po ai, po aty*, fq. 72.

¹⁴ *Po ai, po aty*, fq. 72.

1- Parimin e përgjithshëm pedagogjik për mësimdhënien dhe të nxënët, që merr parasysh etapën e të mësuarit, nivelin e dijeve të nxënësit, moshën e tyre etj.; 2- Zgjedhjen e lëndës, fjalësin, tërësinë e fjalëve, të kuptimeve e shprehjeve që do të përfshihen në të. Kriter themelor mund të ishte denduria e përdorimit; 3- Dhënien e gjedheve të qarta të bashkëlidhjeve të fjalëve, të grupuara në mënyrat e duhura që tregojnë konkretisht si mund të përdoret fjala.¹⁵

Pyetja *A duhet botuar një fjalor shpjegues shkollor i gjuhës shqipe?* e artikullit në fjalë, ka marrë përgjigje konkrete përmes veprës “Fjalor i gjuhës shqipe” (për shkollën), Tiranë, 2020, 112 f., ku Shehu është bashkautor, si dhe “Fjalor i gjuhës shqipe” (për shkollat e vegjël), vepër për shtyp, ku përsëri Shehu është bashkautor - siç informohemi nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Edhe profesorët Shezai Rrokaj e Anila Kananaj kanë botuar dy fjalorë të këtij lloji: “Fjalor i gjuhës shqipe” për moshën 5 – 11 vjeç, Tiranë, 2022 dhe “Fjalor i gjuhës shqipe” për moshën mbi 12 vjeç, Tiranë, 2022.

Si një nga leksikologët dhe leksikografët që ka ndjekur dhe ndjek nga afër botimet e ndryshme nga leksikografia krahinore, prof. Shehu vjen në revistën “Gjuha shqipe” edhe me artikullin me temë **“Për një fjalor të përgjithshëm dialektor të gjuhës shqipe”**¹⁶. Ai thotë: “Fjalorët janë një nga veprimtaritë e institucionalizuara të kulturës sonë. Kemi disa fjalorë shpjegues kombëtarë të gjuhës shqipe. Kemi shumë fjalorë terminologjikë. Kemi jo pak fjalorë krahinorë, të ashtuquajtur “Fjalorë me fjalë e shprehje” nga aksh krahinë. Na duhet një fjalor i përgjithshëm dialektor.”¹⁷ Artikulli sjell 14 argumente, të shtjelluara qartë në lidhje me çështjen: *Përse duhet hartuar e botuar një Fjalor i përgjithshëm dialektor i shqipes*. Po veçojmë një prej tyre: “Fjalorët janë libra referimi. Por ky Fjalor mund të ishte më shumë se kaq. Ai do të ishte libër që do të lexohej e që do të qëmtohej, sidomos nga shkrimtarët, etnografët, terminologët etj., për t’ia kthyer këto mjete gjuhësore gjithëdialektore popullit si mjet kulture.”¹⁸

Autori e mbyll artikullin me një kërkesë: Të krijohen skedarë me fjalë e shprehje popullore në ato qendra qytetore, ku ndiehet se është mbledhur e pasqyruar pak leksiku popullor dhe fton të japin kontributin e tyre të gjithë mbledhësit e zellshëm të fjalës së popullit dhe të gjithë dashamirësit e gjuhës shqipe.¹⁹ Kërkesa e prof. Shehut vijon më tej duke u shprehur: “Në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë, ose në Institutin Albanologjik, Prishtinë, duhet të ngrihet kartoteka e përgjithshme e leksikut dialektor e krahinor të shqipes, përfshirë edhe leksikun arbëresh, sepse puna hartuese mund të bëhet vetëm me këtë kartotekë”²⁰

Artikullin me temë **“Për një fjalor drejtligjërimit të gjuhës shqipe”**²¹, Shehu e nis me një shpjegim për llojin e fjalorit: “Fjalori drejtligjërimit është fjalor i bashkëlidhjeve të fjalëve, ose sipas metagjuhës sonë leksikografike, i thënieve. Thënia ka të bëjë drejtpërdrejt me glosën: plotëson shpjegimin e fjalës; e paraqit fjalën në kontekst; dallon një kuptim nga një tjetër; ilustron gjedhen gramatikore; shembullson thënie të tjera tipike të përdorimit të fjalës; diferencon sinonimet, homonimet, paronimet etj.”²² Studiuesi Shehu shpreh mendimin se “gjuha shqipe duhet të ketë një fjalor mirëfilli ortologjik”²³.

Sipas tij, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) mund të konsiderohet si një fjalor ortologjik (i fjalëpërdorimit), sepse i ka pasqyruar shumë gjerë bashkëlidhjet e fjalëve. Megjithatë, nevojitet një fjalor mirëfilli ortologjik, për disa arsye: *Së pari*, sepse që atëherë (1980) është rritur e zgjeruar shumë sintagmatika e shqipes. Edhe njohja e vjelja e saj. Edhe leksiku.

¹⁵ *Po ai, po aty*, fq. 74.

¹⁶ H. Shehu, *Për një fjalor të përgjithshëm dialektor të gjuhës shqipe*, në “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 2 / 2013, fq. 79.

¹⁷ *Po ai, po aty*, fq. 79.

¹⁸ *Po ai, po aty*, fq. 83.

¹⁹ *Po ai, po aty*, fq. 85.

²⁰ *Po ai, po aty*, fq. 85.

²¹ H. Shehu, *Për një fjalor drejtligjërimit të gjuhës shqipe*, në “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 3 / 2013, fq. 67.

²² *Po ai, po aty*, fq. 67.

²³ *Po ai, po aty*, fq. 68.

Së dyti, mënyra e përdorimit të fjalëve tregon shumësinë e bashkëlidhjeve (teksteve) ku hyjnë ato. Por këtë shumësi bashkëlidhesh (tekstesh) nuk mund ta pasqyrojë (dhe nuk e ka për detyrë ta pasqyrojë) as edhe një fjalor i madh shpjegues, për arsye të kufizimeve që vijnë nga parimet dhe kriteret leksikografike. Këtë mund ta bëjë dhe e ka për detyrë ta bëjë një fjalor më i specializuar – fjalori drejtligjërimitor.”²⁴ Kërkesat për nevojën e një fjalori drejtligjërimitor (ortologjik), Shehu i mbështet te vlerat e tij si vepër gjuhësore, duke i renditur e trajtuar bindshëm, shoqëruar edhe me shembullsime.

Profesori mendon se katër parime kryesore mund të kihen parasysh për hartimin e fjalorit drejtligjërimitor: a) Thëniet duhet të vihen sistematikisht dhe vazhdimisht: për çdo glosë e për çdo kuptim a ngjyresë kuptimore. b) Thëniet me natyrë frazeologjike duhen shpjeguar, sepse në shumë prej tyre, kuptimi i togfjalëshit nuk mund të nxirret nga kuptimet e veçanta të fjalëve që e përbëjnë; ndryshe, krijohet zbrazëtirë, paqartësi e padije. c) Thëniet duhet të jenë të tilla që të pasqyrojnë kulturën gjuhësore të folësve të shqipes. ç) Thëniet të jenë tipike, domethënë, të pasqyrojnë bashkëlidhjen reale sendore-logjike. d) Thëniet të jenë autentike. Të jenë autentike do të thotë që të mos kenë pavarësi krejtësisht nga konteksti, sepse kështu rroket edhe kuptimi, edhe përdorimi i fjalës së dhënë.²⁵

Sipas prof. Shehut, Fjalori drejtligjërimitor do të mbante tërë peshën e ilustrimit dhe do të shpërfaqte tërë gjaninë e përdorimore të fjalëve të shqipes. Ndërsa, në punimin tjetër me temë **“Aleksandër Xhuvani, “Fjalor i gjuhës shqipe”**”²⁶, autori shkruan: “Faqe shumë e vyer e traditave të zhvillimit dhe të historisë së leksikografisë shqiptare është e tërë veprimtaria shkencore gjuhësore e profesor Aleksandër Xhuvanit e veçmas, studimet e tij për leksikun e shqipes, për fjalëformimin e shqipes, për fjalëpërdorimin e shqipes. Një vepër e tij e veçantë leksikografike është “Fjalor i gjuhës shqipe”.²⁷

Artikulli nis me vlerësimin për Fjalorin, kryesisht për lëndën leksikore dhe frazeologjike që pasqyrojnë. Dhe vijon duke pohuar që: *Aleksandër Xhuvani ka qëmtuar e vjelë për Fjalorin e tij një letërsi të gjerë shqipe – artistike, publicistike, etnografike, etnografike-gjuhësore, folklorike, mësimore, fetare, fjalorë të gjuhës shqipe a me gjuhën shqipe, dhe drejtpërdrejt, ligjërime popullore krahinore. Lënda e vjelë dhe e pasqyruar është si për një Fjalor të madh të gjuhës shqipe. Ajo zë fill me Buzukun. Vijon me Budin e Bogdanin. Dhe kjo do të thotë që Fjalori shkon përtej Rilindjes Kombëtare. Pastaj vijon me rilindësit, “Fjalorin e gjuhës shqipe” të Kristoforidhit, Fjalorin e Bashkimit e të Gazullit etj. Ky është një vizion i gjerë i profesor Xhuvanit për fjalorin e gjuhës shqipe.*²⁸

Vlerësimi tjetër i leksikologut Shehu lidhet me synimin e prof. Aleksandër Xhuvanit për gjetjen e pasqyrimin e fjalës a shprehjes gjithëkombëtare, pavarësisht përkatësisë letrare, historike a krahinore. Sipas tij, kjo është fytyra e Fjalorit të Xhuvanit, dhe ndalon duke paraqitur si vlerë të veçantë të Fjalorit sjelljen e pasurisë së panjohur e të papasqyruar leksikore, kuptimore e frazeologjike popullore me vlerë letrare potenciale objektive për rritjen e mëtejshme të leksikut të gjuhës së njëzuar letrare shqipe.²⁹

Shehu shquan e analizon disa tipare të këtij *Fjalori*, si: Ka elemente diakronike e etimologjike si të një fjalori historik të shqipes; Është leksikor, por edhe kulturor-enciklopedik, sepse përfshin shumë glosa që kanë të bëjnë me kulturën (tradicionale) shqiptare; Ka informacion etnografiko-gjuhësor, etnobotanik e etnozoolojik; Në Fjalor vijnë edhe emra visesh, nga është vjelë e mbledhur lënda; vijnë edhe toponime si glosa.³⁰

²⁴ Po ai, po aty, fq. 68.

²⁵ Po ai, po aty, fq. 72.

²⁶ H. Shehu, *Aleksandër Xhuvani, “Fjalor i gjuhës shqip”*, në “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 3 / 2021, fq. 23.

²⁷ Po ai, po aty, fq. 23.

²⁸ Po ai, po aty, fq. 24.

²⁹ Po ai, po aty, fq. 25.

³⁰ Po ai, po aty, fq. 26.

Në vijim, leksikografi e vlerëson Fjalorin e Xhuvanit si *një kontribut shumë të çmuar për Fjalorin e madh kombëtar të gjuhës shqipe*, duke pohuar: “Vepra është Fjalor i gjuhës shqipe me vjeljen dhe mbledhjen e leksikut, me tërë pasurinë leksikore dhe frazeologjike që ajo shpërfaq. Fjalori përfshin 17000 fjalë e 1500 frazeologji. Janë fjalë e frazeologji të gjuhës së përgjithshme, të gjuhës standarde dhe të të folmeve. Meritë e veçantë e Fjalorit është se vë në qarkullim fjalë e njësi frazeologjike, sidomos nga të folmet krahinore, nga leksiku i vjetër i shqipes etj., të panjohura e të papasqyruara në fjalorët e deritanishëm, por që mund të hyjnë në gjuhën e përbashkët letrare sepse sjellin vlera pasuruese për të”³¹. Në mbyllje të artikullit, Shehu shprehet me këto fjalë: “... *prof. Xhuvani ka bërë një punë të madhe fort. Me ndezulli të madhe fort...*”³²

II. Janë të shumtë artikujt e botuar nga gjuhëtari Hajri Shehu në revistat e sipërpërmendura. Mbi pesëdhjetë prej tyre i ndeshim në përmbledhjen studimore me titull **“Studime për leksikun dhe për leksikografinë e sotme shqipe” I** (2015), ndërkohë që **“Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe” II** pret të botohet. Vepra në fjalë mbulon një tematikë të gjerë, referuar leksikologjisë e leksikografisë (sidomos leksikut popullor me vlerë potenciale për gjuhën e sotme shqipe), fjalëformimit në gjuhën shqipe e kulturës së gjuhës, që dëshmojnë qartë kompetencën e lartë shkencore të autorit.

Artikujt për leksikografinë, të shumtë në këtë vepër, mund të klasifikohen në: 1. *artikuj problemorë*, si: “A duhet të përfshihen dialektizma e krahinorizma në një fjalor shqip – gjuhë e huaj?”, “Për një fjalor të përgjithshëm dialektor të gjuhës shqipe”, “Fjala bashkë me fjalën”, “Për një fjalor drejtligjërimit të gjuhës shqipe”, “A duhet botuar një fjalor shkollor i gjuhës shqipe?” etj.; 2. *artikuj recensioes për disa vepra leksikografike*, si: “Fjalor i antonimeve në gjuhën shqipe” i M. Samarës, “Fjalor shqip – anglisht i Oksfordit (Oxford Albanian-English Dictionary) i L. Njumarkut, “Fjalor arabisht – shqip” i S. Tomçinit, “Fjalor persisht – shqip” i hartuar nga një grup autorësh etj.; si dhe *për disa monografi me karakter leksikologjik*, si: “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” i J. Thomait; “Parafjalët në shqipen e sotme” i M. Samarës; “Termi dhe fjala në gjuhën shqipe” i A. Duros; “Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor në viset veriore të Shqipërisë (në përjasje me të folmet e tjera të gjuhës shqipe)” i S. Pepës etj.

Mes tubës së punimeve të kësaj *përmbledhjeje studimore*, veçojmë një artikull të shkurtër, me temë **“Për paronimet në gjuhën shqipe”**, me fokus këtë grupim paradigmatic fjalësh (paronimet) ende të patrajtuar si duhet në gjuhën shqipe. Aty thuhet: “Ashtu si sinonimet, homonimet e antonimet, edhe paronimet përbëjnë një klasë të pasur në gjuhën shqipe. Paronimet lidhen drejtpërdrejt me fjalëformimin. Siç dihet, kur flitet për fjalëformimin, shihen edhe lidhjet e lëvizjet kuptimore të fjalëve. Paronimet na japin një lëndë të pasur për t’i vëzhguar këto lidhje e këto lëvizje kuptimore në mënyrë të sistematizuar”³³.

Prof. Shehu është leksikologu që shquan e thekson rëndësinë e veçimit të këtij grupi fjalësh, duke sugjeruar edhe një studim të thelluar për to, i cili mund të hapte rrugë pastaj për një fjalor të paronimeve të gjuhës shqipe, a thënë ndryshe, për “fjalët e ngatërrueshme” në gjuhën shqipe – shumë i vlefshëm për nxënësit, studentët, të huajt etj. Veprimtaria shkencore e profesor Shehut vijon me shumë studime të tjera të rëndësishme për fjalën e leksikun e shqipes, siç është edhe **“Fjalori me fjalë e shprehje popullore nga Ujemuja” (Qarku i Dibrës)**, 2016 – vepër me cilësi të lartë shkencore, që sjell një pasuri leksikore, frazeologjike e semantike të panjohur përgjithësisht, me vlera të shumta për mbrojtjen e pasurisë gjuhësore vetjake të shqipes, për pasurimin e leksikut të saj dhe për studimet shkencore në fushë të leksikut të shqipes.

³¹ *Po ai, po aty*, fq. 29.

³² *Po ai, po aty*, fq. 37.

³³ H. Shehu, “Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe”, Tiranë, 2015, f. 173.

Lënda e mbledhur nga gjuhëtari ynë në këtë Fjalor, me kujdesin e studiuesit të përkushtuar, e trajtuar, e analizuar dhe e zërthyer kuptimisht në mënyrë të hollësishme, sipas parametrave leksikorë të gjuhësisë sonë të sotme, përbën një pasuri gjuhësore me shumë vlerë.

III. Në revistën “**Studime filologjike**” 1-2 / 2018, do të publikohej artikulli i Shehut me temë “**Fjala si njësi e mëvetësishme e fjalësit**”³⁴. Shkrimi nis me përkufizimin gjuhësor për fjalën: “Fjala është njësi e mëvetësishme më e vogël e gjuhës, që përbëhet nga disa tinguj a nga një tingull, e formësuar gramatikisht, që shënon sende e dukuri të realitetit ose shpreh qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë, lidh gjymtyrë të një fjalie ose fjali dhe riprodhohet e veçohet në rrjedhën e ligjëritimit.” (*Fjalor i gjuhës shqipe*, 2006. [Hajri Shehu është hartuesi i fjalëve të shkronjës F.]).

Edhe leksikografikisht, fjala është “njësia e mëvetësishme më e vogël e gjuhës ..., e formësuar gramatikisht, që shënon sende e dukuri të realitetit ose shpreh qëndrimin e folësit ndaj asaj që thotë ...”³⁵ - shkruan Shehu, duke pasur parasysh se koncepti leksikografik ndjek konceptin gjuhësor. Në këtë conceptualizëm mbi *fjalën si njësi e mëvetësishme e një fjalori*, autori përveçon disa koncepte:

Arsyetimin e nis me pohimin se *në çdo gjuhë ka më pak fjalë se nocione* dhe vijon: “*Sikur të gjitha nocionet e përpunuara nga një popull, të kishin nga një veshje tingullore, leksiku i gjuhës do të ishte kaq i madh, sa njohja e tij do të ishte e pamundur nga pjesëtarët e bashkësisë ligjërimore, për të mos thënë që komunikimi mund të bëhej i vështirë*”³⁶. Shehu shtjellon mendimin më tej duke pohuar se *mrekullia e gjuhëve është shumëkuptimësia* (e cila është njëherësh edhe ekonomi gjuhe), pra, mundësia e fjalës për të shërbyer si veshje tingullore për disa a për shumë nocione. (Sigurisht, te fjala, në çdo akt të komunikimit gjuhësor, nocioni a koncepti mund të saktësohet edhe me ndihmën e mjeteve të tjera gjuhësore – morfologjike, sintaksore etj.) *Këtë mrekulli e ka edhe gjuha shqipe – vë në dukje gjuhëtari, duke shpjeguar që “Pasuria e leksikut të gjuhës shqipe dhe e fjalorit të saj nuk mund të shihet vetëm te numri i përgjithshëm i fjalëve dhe nuk mund të përcaktohet vetëm me numrin e përgjithshëm të fjalëve, por edhe me kuptimet e ngjyresat e tyre kuptimore.”*³⁷

Kujtojmë këtu që: kuptimet e fjalëve janë struktura konceptore e gjuhës, si dhe zhvillimet kuptimore të fjalëve janë edhe një ndër tiparet e zhvillimit të gjuhës. Shehu i kushton vëmendje edhe konceptit *mbi sistematizimin e kuptimeve të fjalëve* në Fjalorët e shqipes, duke na kujtuar që fjalori dallon kuptimet e kryehershme, kuptimet e reja të fjalëve të vjetra, poliseminë nga homonimia etj. Të gjitha këto përdallime janë çështje *ffjale* – me karakteristikat përkatëse gramatikore e stilistikore.³⁸

Gjithashtu, *fjalëformimi*, si një nga mekanizmat gjuhësorë më të rëndësishëm që siguron shumësi të leksikut, bëhet objekt hulumtimi me vlerë në punim. Sipas Shehut, shumësia e leksikut është e pafund; veçse nuk është në atë shkallë në të cilën gramatika siguron pafundësinë e frazave (ndërtimin e pafund të frazave). Fjalëformimi e krijon potencialisht mundësinë për pafundësi të leksikut, por kjo mundësi nuk mund të realizohet kurrë. Kjo varet, sigurisht nga tradita gjuhësore e bashkësisë ligjërimore. Për të ilustruar se deri ku shkon pafundësia dhe mundësia, jepen këto raste: - me folje më -o·j (tipi *veson, borëton, breshëron*, por jo *shijon* (bie shi)); - me fjalë të përbëra pronësore (tipi *zemërluan*, por jo *zemërtigër, zemërdele* ...). Atëherë, është fjalori ai që na i tregon fjalën dhe fjalët, mundësinë dhe pamundësinë, edhe pse ka kufizime për arsye të vëllimit e të prerjes së tij.

³⁴ H. Shehu, *Fjala si njësi e mëvetësishme e fjalësit*, në revistën “Studime filologjike” 1-2, Tiranë, 2018, f. 73 - 81.

³⁵ Po ai, po aty, f. 73.

³⁶ Po ai, po aty, f. 73.

³⁷ Po ai, po aty, f. 73.

³⁸ Po ai, po aty, f. 74.

Në fjalë dhe në fjalor “lexohen” proceset sinkronike të fjalëformimit: struktura e fjalës – tema, rrënja, ndajshesat etj. Për atë që di më shumë, fjalori i tregon si formohen fjalët e reja në gjuhë, si përplotësohet leksiku i gjuhës standarde.³⁹ Nuk mungon në këtë artikull as koncepti mbi *variacionet brendagjuhësore* (për të folme të caktuara brenda gjuhës kombëtare ose për periudha të caktuara kohore të zhvillimit të gjuhës) e *variacionet ndërgjuhësore* (për sende, institucione e koncepte unike, të veçanta për aksh shoqëri), ku pas të gjitha këtyre qëndrojnë *fjalët*.⁴⁰

Fjala në konceptin leksikografik merr vëmendje të veçantë në punim. Shehu shkruan: “Fjala është njësi e mëvetësishme e fjalorit, por në bashkëlidhje me fjalë të tjera të leksikut. Bashkëlidhja e tyre është një nga teknikat themelore shpjeguese në fjalorë. Është ilustrimi i glosës me shembuj përdorimi.”⁴¹ Dhe vijon me këto shpjegime: Ekzistenca objektive e një fjale mund të provohet nga fakti se mund ta marrësh nga ky kontekst e ta futësh në një tjetër kontekst (tipi *dorë e majtë / dorë e djathtë*). Por, bashkëlidhjet e fjalëve përcaktojnë jo vetëm kuptimin e një fjale. Ato kanë edhe vlerë denotative (krahaso *kopsht fëmijësh, të kuq buzësh, Udha e Qumështit, lule dhensh, lule peshku, arra e fytit, flutura e rregullatorit* (në teknikë), *bar shpretke, bar blete, gjethe delli* etj.).

Bashkëlidhja e fjalëve pasqyron lidhjet valencore të tyre. Ajo është jo vetëm koncept gjuhësor, e sidomos leksikologjik e leksikografik, por edhe koncept metodik - në fjalorët dygjuhësh (shqip – gjuhë e huaj), në fjalorët shkollorë etj. Bashkëlidhja e fjalëve është edhe një ndër parimet e zgjedhjes së minimumit leksikor. Një studim krahasimtar me gjuhë të afërta ose edhe të paafërta tipologjikisht, do të jepte mundësi të krijoheshin edhe universale semantike-ligjërimore.⁴² Në shpjegimin për fjalën si njësi e leksikut, del qartë edhe *lidhja e ngushtë e leksikologjisë me stilistikën*.

Shehu thotë që duhet të zbulosh përmbajtjen e saj kuptimore dhe karakteristikat stilistike për çdo kuptim, e këtë detyrë e zgjidh fjalori shpjegues. Por kjo është vetëm gjysma e punës; duhet të përcaktosh edhe vendin e çdo *fjale* në sistemin leksikor të gjuhës e në radhë të parë, vendin e fjalëve më të afërta për nga kuptimi (sinonimet). Dija për sinonimet ka të bëjë në thelb me stilistikën e gjuhës. E sigurisht, me shumëkuptimshmërinë e *fjalës*, me poliseminë e gjuhës.⁴³

Për *karakterin normativ të fjalorit*, studiuesi ynë pohon: “Fjala në fjalor nuk mund të quhet e mirëqenë pa normën letrare.”⁴⁴ Dhe vijon me konceptin *sistem gjuhësor* si tregues i standardizimit, duke thënë: “Po të mos kishte rregulla e qëndrueshmëri në kombinimin e njësive leksikore, nuk do të ishim në gjendje të komunikonim me njëri-tjetrin; po të ndryshonte shumë raporti *njësi / kuptim*, komunikimi do të ishte i pamundur.”⁴⁵ Por, *norma letrare* është koncept shumë më i gjerë për Shehun, kur shprehet: “... është tërësia e rregullave që përcaktojnë përdorimin e mjeteve gjuhësore në mënyrë të njëllojtë për të gjithë pjesëtarët e një kombi – ngulitur e pranuar nga të gjithë pjesëtarët e një kombi si në ligjërimin e folur, ashtu edhe në ligjërimin e shkruar; kësisoj, norma ruan identitetin e ligjërimin të bashkësisë, duke e rritur kohezionin e saj, sepse vepron rregullsisht *gjuhë – normë – ligjërim*.”⁴⁶

Në lidhje me *rolin kodifikues të fjalës së fjalorit kombëtar*, për ruajtjen dhe zhvillimin e normës, leksikografi Shehu pasi shprehet që *fjalori kombëtar duhet të pasqyrojë përdorimin më të mirë të një gjuhe*, ndalon tek disa veçori që vënë në dukje ndikimin e fjalorëve në gjuhën

³⁹ Po ai, po aty, f. 74.

⁴⁰ Po ai, po aty, f. 74.

⁴¹ Shih një punim të plotë të H. Shehut: *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*, në “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005, f. 158-168.

⁴² H. Shehu, *Fjala si njësi e mëvetësishme e fjalësisë*, në revistën “Studime filologjike” 1-2, Tiranë, 2018, f. 76-77.

⁴³ Po ai, po aty, f. 76.

⁴⁴ Po ai, po aty, f. 77.

⁴⁵ Po ai, po aty, f. 77.

⁴⁶ Po ai, po aty, f. 77.

standarde, si: *korrektësia gramatikore, informacioni për fushën e përdorimit dhe për statusin stilistik të fjalëve, variacioni leksikor, social dhe gjeografik* etj. Në mbyllje të argumentit, Shehu pohon: ... *Fjalori ndikon në qëndrueshmërinë e standardit. Fjalori nuk është sigurisht ligjvënës, por përshfaq përdorimin e gjuhës letrare kombëtare.*⁴⁷ Paraqitja me korrektësi profesionale e shkencore e fjalëve është një detyrë shumë e rëndësishme për të kuptuar zhvillimin e gjuhës standarde dhe natyrën e funksionimit të fjalorit për standardizimin në tërësi.

Përfundim

Punimet për fjalën e leksikun e shqipes kanë rrokur pothuajse gjithë veprimtarinë shkencore të gjuhëtarit Shehu, trajtuar *me kompetencë të lartë shkencore* - siç do të vlerësohej edhe nga kolegë të tij të fushës, me kontribute me vlerë në gjuhësinë shqiptare, si: Jani Thomaj⁴⁸, Thanas Feka⁴⁹, Valter Memisha⁵⁰, Enver Hysa⁵¹ etj.

Së shpejti, urojmë të kemi në dorë një vepër tjetër të çmuar nga arkivi i pasur i studiuesit të palodhur për gjuhën shqipe, prof. Hajri Shehu.

Referenca

- [1]. Hajri Shehu, “Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe”, Tiranë, 2015.
- [2]. Hajri Shehu, *Fjala si njësi e mëvetësishme e fjalësit*, në revistën “Studime filologjike” 1-2, Tiranë, 2018.
- [3]. Revista “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 2007 - 2023.
- [4]. Jani Thomaj, Hajri Shehu, “Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës”, QSA, IGJL, Tiranë, 2016, 436 f., në revistën “Studime filologjike”, 3-4, Tiranë, 2018.
- [5]. Valter Memisha, *Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës (Qarku i Dibrës) - si gjedhe e punës në leksikografinë dialektore*, në librin “Studime për fjalën shqipe” 6, Tiranë, 2021.
- [6]. Enver Hysa, *Recension*, në librin: H. Shehu, “Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës (Qarku i Dibrës)”, Tiranë, 2016.
- [7]. Thanas Feka, *Parathënie*, në librin: Hajri Shehu, “Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe”, Tiranë, 2015.
- [8]. ASHSH (IGJL), ASHAK, “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.

⁴⁷ Po ai, po aty, f. 79.

⁴⁸ J. Thomaj, Hajri Shehu, “Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës”, QSA, IGJL, Tiranë, 2016, 436 f., në: “Studime filologjike”, 3-4, Tiranë, 2018, fq. 287.

⁴⁹ Th. Feka, *Parathënie*, në: Hajri Shehu, “Studime për leksikun dhe leksikografinë e sotme shqipe”, Tiranë, 2015, fq. 7.

⁵⁰ V. Memisha, *Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës (Qarku Dibrë) – si gjedhe e punës në leksikografinë dialektore*, në “Studime për leksikun dhe leksikografinë dialektore”, Prishtinë, 2020, fq. 50.

⁵¹ E. Hysa, *Recension*, në: H. Shehu, “Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemujës (Qarku i Dibrës)”, Tiranë, 2016, fq. 6.